Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikime
Nacionalni Autoritet za Kvalifikac
National Qualification Authority

Numër: 01/399
Datë: 20.08.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Riakreditohet "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 15.12.2020 deri 14.12.2023 me kualifikimin:

   1.1 **NËPUNËS KONTABILITETI,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

2. Akreditohet "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2021 deri 19.08.2024 me kualifikimet:

   2.1. **TEKNIK I KONTABILITETIT,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 55 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tetë (8) grupe.

2.2. **KONTABILIST I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 96 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) grupe.

2.3. **AUDITOR I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 100 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga tridhjetepesë (35) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

2.4. **AUDITOR I BRENDSHËM NË SEKTORIN PRIVAT DHE PUBLIK,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga tridhjetë (30) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

2.5. **VLERËSUES I BIZNESEVE I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 50 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

2.6. **VLERËSUES I BIZNESEVE I LICENCUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 50 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.7. **EKSPERT I LICENCUAR I FORENZIKËS FINANCIARE,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.8. **KËSHILLTAR TATIMOR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 49 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

2.9. **KËSHILLTAR TATIMOR I LICENCUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.10. **KONTROLLOR I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 36 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.11. **KONTROLLOR I LICENCUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 24 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.12. **AUDITOR I IT I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 40 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzet (20) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.13. **MENAXHER I RISKUT I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 40 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.14. **CFO I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 50 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2.15. **ZYRTAR I CERTIFIKUAR NE MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 55 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

3. **Refuzohet** akreditimi i "Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për kualifikimin:

CERTIFIKIM NË IPSAS, niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 75 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Bedri Pejani, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, për validim dhe akreditim të institucioni dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv lidhur me pikat një (I) dhe dy (II) si në dispozitivin e këtij vendimi, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i jashtëm i ekspertëve me datë 30 prill 2021 ka shqyrtuar dokumentacionin e institucionit IKAF, ndërsa me datë 07 maj 2021 ka vizituar institucionin IKAF lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimin Certifikim në IPSAS.

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportin e validimit dhe akreditimit për institucionin IKAF, lidhur me kualifikimin Certifikim në IPSAS, në pjesën: *Qartësimi për kushtet e rekomanduara nga ekipi i ekspertëve,* ekspertët vlerësojnë se: IKAF nuk ka ofruar dëshmi se ka pasur sugjerime apo mbështetje nga sektori përkatës, në këtë rast institucionet buxhetore të Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh faktin që Republika e Kosovës e ka pavarësinë e vendosjes lidhur me adaptimin dhe futjen në zbatim të IPSAS dhe se aktualisht akoma nuk ka një kornizë ligjore të adaptuar për kalimin në "IPSAS", rrjedhimisht nga kjo mbetet e pa qartë se kur dhe si do të kemi të adaptuar kornizën ligjore lidhur me kalimin në "IPSAS" mbi bazën aktuale për raportim financiar të institucioneve buxhetore të Republikës së Kosovës. Ekspertët në të njëjtën pike vlerësojnë po ashtu se: Ndarja e orëve në raportin 1 me 2 sipas dëshmive të datës 21.06.2021, ku janë

sqaruar 1 orë ligjërata/ushtrime dhe 2 orë vet-studim nuk është bërë sqarim sipas kërkesave nga paneli, në këtë profil janë 1500 orë të parapara për këtë nivel sipas standardit të profesionit nëse kjo shumë ndahet në raportin 1 me 2 i bie që 1000 orë të llogariten vet-studim duke llogaritur kohën për përgatitjet për provime, projektet, hulumtimet, pjesëmarrja në seminare Workshope (punëtori) këto orë rekomandohet të kenë shtrirje të mbushur me aktivitetet të mbikëqyrura nga mësimdhënësit, kurse 500 orë tjera duhet të mbahen direkt me trajnerin dhe që llogariten orë kontakti direkt dhe të ndahen varësisht nga pesha e moduleve tek pjesa e ligjëratave, ushtrimeve dhe vlerësimit. IKAF orët e planifikuara për orët teorike profesionale dhe orët praktike të gjitha duhet të mbajë nën mbikëqyrjen direkt me trajnerin si orë kontakti, po ashtu orët teorike plotësuese nuk mundë të llogariten si orë për arritjen e kredive për kualifikim.

Në raportin e validimit në piken ku trajtohet **"Kualifikimi/moduli ka synime, objektiva të qarta dhe transparente, ka mbështetje nga grupet e interesit si dhe ofron mundësi për progres"**, ekspertët vlerësojnë se: Instituti tek formulari i aplikacionit për validim faqe 3, pohon se modulin e ka zhvilluar në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), nga e cila ka marrë të drejtën e përdorimit të materialeve për qëllime të ligjërimit për këtë certifikim, materiale të cilat janë publikuar me datë 9 Nëntor 2020 të njohura si "Train the Trainer: Introduction to IPSAS", mirëpo në dosje për validim nuk është ofruar një dëshmi e tillë. Ekspertët në raportin e validimit në piken ku trajtohet **"Kualifikimi/moduli ka mbështetje nga sektori përkatës"**, vlerësojnë po ashtu se: IKAF përpos marrëveshjeve të dëshmuara me "IFAC" lidhur me përkthimin dhe përdorimin e standardit ndërkombëtar të edukimit (IES) dhe kodin e etikës për profesionist si dhe librin nga "Accounting for Governments: from Budget to Audit" si dhe marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare si për bashkëpunim te ndërsjellët në fushën e profesionit gjithashtu edhe në njohje të certifikatave të lëshuara nga IKAF, nuk ka ofruar dëshmi se ka pasur sugjerim apo mbështetje nga sektori përkatës, në këtë rast institucionet buxhetore të Republikës së Kosovës.

Në raportin e validimit në piken ku trajtohet **"Kualifikimi ka përshkrim të qartë të përmbajtjes, rezultateve të të nxënit, moduleve obligative dhe zgjedhore"**, ekspertët vlerësojnë se: IKAF për këtë profil ka paraparë numër të konsiderueshëm të ushtrimeve me softuer dhe nuk ka përshkruar se çfarë konkretisht përmbajnë ushtrimet me softuer, dhe si do e monitoroj përmes një shpjegimi të detajuar. Duke ditur që softueri është një term i përgjithshëm që përdoret për t'iu referuar aplikacioneve, skriptimeve dhe programeve që ekzekutohen në një pajisje, pra IKAF nuk ka shpjeguar konkretisht çka ka paraparë tek ushtrimet me softuer. IKAF, në aplikacion për validim nuk ka ofruar

dëshmi mbi ndonjë analizë të bërë si dhe metodologjinë e zhvillimit të programit dhe ekspertëve të cilët janë marrë me zhvillimin e moduleve për këtë kualifikim.

Në raportin e validimit në piken ku trajtohet "**Numri i orëve të nevojshme për arritjen e kualifikimit/modulit**", ekspertët vlerësojnë se: Numri i orëve i shprehur në kredi, është i përshkruar dhe ndarë në formularin e validimit. Në formular përshkruhen modulet dhe orët për secilin modul. Programi "Certifikim në IPSAS" është paraparë të zgjatë 1500 orë ose 75 kredi (20 orë = 1 kredi), prej të cilave 310 orë teorike, 554 orë praktike, 620 orë për vetë-studim dhe 16 orë vlerësim. Duke u bazuar në numrin e orëve në kontakt me trajnerin atëherë kjo shumë e orëve nuk siguron as minimumin e arritjeve të kompetencave profesionale për këtë profil. Duke marr parasysh pasqyrimin e orëve si më lartë komisioni vjen në konkludim se orët e parapara nuk janë shpërndarë, detajuar, adresuar dhe specifikuar sipas temave që do të ligjërohen.

Në raportin e validimit në piken ku trajtohet "**Kualifikimi/moduli përfshin tregues dhe kritere për vlerësim të cilat sigurojnë bazë të vlefshme dhe objektive në vlerësimin e kandidatëve**", ekspertët vlerësojnë se: Kriteret e vlerësimit dhe RM nuk përfshijnë ushtrimet me softuer të cilat janë paraparë në këtë kualifikim pasi janë orë të grupuar tek shpërndarja e orëve për vet-studim, mirëpo kjo shpërndarje e orëve në 1500 orëve të parapara, është vetëm 10% e orëve teorike, dhe 38% ushtrime me softuer ku konkretisht nuk dihet se çfarë është paraparë pasi që, softuer është termi i përgjithshëm dhe nuk dihet, nëse ju ka referuar ndonjë aplikacioni financiar konkret mbi raportimin e të dhënave kontabël apo diç tjetër. Gjithsesi që kriteret e përkthyera nga burim në fjalë janë valid, por duke marr parasysh që shpërndarja e orëve në 10% orë teorike si dhe në 83% orë vet-studim komisioni mendon që IKAF duhet të bëj rishpërndarjen e orëve dhe të evitoj mangësitë e qartësuar më lartë.

Në raportin e validimit në piken ku trajtohet "**Shfrytëzimi i standardit apo i kualifikimit/modulit i bazuar në standard ndërkombëtar të profesionit dëshmohet nga institucioni**", ekspertët vlerësojnë se: Instituti tek formulari i aplikacionit për validim faqe 3, pohon se modulin e ka zhvilluar në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), nga e cila ka marrë të drejtën e përdorimit të materialeve për qëllime të ligjërimit për këtë certifikim, materiale të cilat janë publikuar me datë 9 Nëntor 2020 të njohura si "Train the Trainer: Introduction to IPSAS", mirëpo në dosje për validim nuk është ofruar një dëshmi e tillë.

Në raportin e validimit në piken ku trajtohet "**Kualifikimi/moduli përfshin procedurën e vlerësimit praktik, në institucion dhe ndërmarrje me dëshmitë e kërkuara**", ekspertët

vlerësojnë se: Ka raste kur dëshmohet se në marrëveshjet e bashkëpunimit të dërgohen kandidatët tek institucioni, por kjo pikë nuk është elaboruar në ndonjë dokument aneks.

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në raportin e ekspertëve vlerësues lidhur me validimin dhe akreditimin e institucionit "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)" për profilin Certifikim në IPSAS, niveli (V) sipas KKK, me 75 kredi të AAP, mbështetur në të gjeturat e eksperteve të dhëna në: Raportin vlerësues për validim dhe Raportin vlerësues për akreditim vendosi si në piken tre (III) të dispozitivit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF), dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK